KOMUNA GLLOGOC
GLLOGOC MUNICIPALITY
PRANUAR 03/09/ 2024
Nj. Org. | Numër | Shtojca | Vlera
01 - 060/01 - 43257

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Drenasit
Zyra e Kryetarit

**PROCESVERBAL NGA TAKIMI I KËSHILLIT KOMUNAL PËR SIGURI NË BASHKËSI (KKSB)**

**IZVEŠTAJ O SASTANKU OPŠTINSKOG ODBORA ZA BEZBEDNOST ZAJEDNICE (OOBZ)**

**Komuna / Opština: Drenas   Data / Datum: 15.08.2024**

**Numri i takimit për këtë vit / Redni broj sastanka u ovoj godini: 4**

**Takim i rregullt / Redovni sastanak** ☒   **Takim i jashtëzakonshëm / Vanredni sastanak** ☐

**Numri i anëtarëve të KKSB-së të pranishëm / Broj prisutnih članova OOBZ: 11**

**A kanë marrë pjesë në takim përfaqësuesit e komuniteteve jo shumicë, nëse janë anëtarë të KKSB-së?**
**Da li su predstavnici nevećinskih zajednica, u svojstvu članova OOBZ, prisustvovali sastanku?**

Po / Da ☐
Jo / Ne ☒
Nuk ka anëtarë që përfaqësojnë komunitetet jo shumicë/Nema članove koji predstavljaju nevećinske zajednice ☐

**A kanë marrë pjesë anëtarë të tjerë përveç anëtarëve të KKSB-së?**
**Da li je neko osim članova OOBZ prisustvovao sastanku?**

Po / Da ☒
Jo / Ne ☐

*Nëse "Po", ju lutem potenconi organizatën të cilën e përfaqësojnë*

*Ukoliko je odgovor "Da", molimo navedite koje organizacije predstavljaju*

***Përfaqësues të KFOR--it***

**A është kryesuar takimi nga Kryetari i Komunës apo nënkryetari?**

**Da li je sastankom predsedavao Gradonačelnik ili Zamenik?**

Po / Da ☒

Jo / Ne ☐

**Temat në rendin e ditës / Teme na dnevnom redu:**
Në mbledhjen e mbajtur me datë 15.08.2024 u diskutuan këto pika të rendit të ditës:

- Procesverbali i mbledhjes së rregullt të KKSB-së të mbajtur me datë 13.06.2024: https://kk.rks-gov.net/gllogoc/ftesa-dhe-procesverbali-i-kksb-se-te-mbajtur-me-13-06-2024/
- Gjendja me zjarre në Komunën e Drenasit, raport nga Njësia e Zjarrfikësve dhe Shpëtimit-NJPZSH;
- Përgatitjet nga DKA për përgatitjet për fillimin e vitit të ri shkollor;
- Të ndryshme

*Ju lutem, potenconi temat tjera për të cilat është diskutuar në të ndryshmet / Molimo navedite druge teme o kojima se diskutovalo:*

**Konkluzionet / Zaključci:**

Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB) ka mbajtur mbledhjen e katërt (4) për këtë vit ku të pranishëm ishin 12 anëtarë të KKSB-së që përfaqësojnë komunitet dhe organizatat në komunën e Drenasit dhe përfaqësues nga KFOR-i. Mbledhja u udhëheq nga nënkryetari i komunës, z. Arben Shala.

1. Procesverbali i mbledhjes së rregullt të KKSB-së të mbajtur me datë 13.06.2024: https://kk.rks-gov.net/gllogoc/ftesa-dhe-procesverbali-i-kksb-se-te-mbajtur-me-13-06-2024/. Është miratuar pa ndonjë vërejtje nga anëtarët;

2. Gjendja me zjarre në Komunën e Drenasit, raport nga Njësia e Zjarrfikësve dhe Shpëtimit- NJPZSH; Lidhur me këtë temë, Shefi i Zjarrfikësve ka raportuar para anëtarëve, duke shprehur shqetësim për

situatën me zjarre në Komunën e Drenasit. "NJPZSH-ja, në Drenas, gjatë ketij viti, ka qenë në gatishmëri të plotë emergjente 24 h shtatë - 7 ditë në javë, më të gjitha kapacitetet dhe resurset të cilat i ka në disponim si në ato materiale, teknike dhe njërzore dhe iu është përgjigjur popullatës në raste rrezikimi si: Në intervenime për fikjen e zjarrit, Në shpetimin e të mirave materiale, Në aksidente të komunikacionit rrugor etj. Vlenë të theksohet se gjatë kesaj periudhe kohore si asnjëher me parë me vështirësia kemi arritur të i'u përgjigjet rasteve emergjente për shkak të numrit të madh të vatrave të zjarrit, numër i vogël i stafit dhe amortizimit të automjeteve dhe mungesës automjeteve zjarrfikëse, mirëpo falë bashkëpunimit me njësitë e shërbimeve të komunave të tjera dhe bashkëpunimit me Zjarrfikësit e Feronikelit kemi arritur t'i menaxhojmë dhe t'i mbajmë nën kontroll situatat emergjente brenda territorit të komunës se Drenasit. Nga muaji **Janar – deri me 15 Korrik 2024**, gjithsej kemi pasur 311 intervenime. Vetëm gjatë muajit gusht kanë ndodh 63 inetvenime për zjarre. Te meren masa për personat që më qëllim ndezin zjarre".

**Nënkryetari Shala:** Personat që ndjezin zjarre qellimisht duhett të raportohet dhe bashkë me Policine brenda mandatit tyre t'i trajtojnë këto raste.

3. Përgatitjet nga DKA për përgatitjet për fillimin e vitit të ri shkollor;

Muhamet Gjoka, Drejtor: DKA është duke punuar në përgatitjet për fillimin e vitit. Kemi hap një konkurs për vendet e lira apo që nuk kanë qenë adekuate për vitin e ri shkollor këtu e kemi prit rregulloren. Pra, jemi të kompletuar sa i përket stafit për fillimin e vitit të ri shkollor. Sfida e njëjtë edhe këtë vit është furnizimi me tekste shkollore. Këtë shqetësim e kemi shprehur tek ministri që jemi vonë për tekste shkollore. Sa i përket materialit pedagogjik, i kemi të pajisur të gjitha shkollat dhe kemi sasi të mjaftueshme. Nuk kemi renovime që do ta pengojnë procesin mësimor. Për lëndë djegëse kemi filluar inicimin e procedurave. Procedurat e regjistrimit të nxënësve i kemi përfunduar.

4. Të ndryshme

**Arben Haziri, Kryetari i Këshillit të Prindërve:** Problemet po vazhdojnë me subvencionimin e teksteve shkollore. Edhe këtë vit problem i njëjtë. Shumë prindër po kanë probleme në kyçje në sitemin e E-Kosvës. Libraritë nuk do të kënë kapacitet që t'i furnizojnë të gjithë fëmijët e shkollave tona. Janë dy ose tri librari dhe nuk kanë kapacitet që t'i furnizojnë të gjithë nxënësit.

**Procesverbali u përpilua nga koordinatori i KKSB-së:**
**Izveštaj pripremio Koordinator OOBZ: Laureta Thaqi**
(emri, mbiemri dhe nënshkrimi / ime, prezime i potpis)

**Procesverbali aprovohet nga Kryetari:** **Ramiz Lladrovci**

**Izveštaj odobrava Gradonačelnik:**

Nënshkrimi / potpis

**Data e aprovimit / Datum odobravanja: 02.09.2024**

***Rekomandimet:***

- *Dërgimi i këtij procesverbali është obligim që del nga UA 27/2012 MPB – 03/2012 MAPL neni 11 pika 6;*
- *Procesverbali përpilohet nga koordinatori i KKSB-së në Komunën përkatëse;*
- *Procesverbali duhet të dërgohet në MPB në e-mail adresën:* mpb.dsb@rks-gov.net
- *Procesverbali duhet të dërgohet në MAPL në e-mail adresën:* Shkrimorja.Mapl@rks-gov.net

*Procesverbali duhet të dërgohet njëkohësisht me ftesën e takimit të ardhshëm të KKSB-së.*